



JOB FAIR - 2010 PANAIRI I PUNËS NË USHT

Për herë të parë në Universitetin Shtetëror të Tetovës, nën organizim të Qendrës për Shërbime Studentore dhe Karrierë - (QESHK) dhe agjencisë turistike për ndërmjetësime studentore "ZIP-Travel", organizohet "PANAIRI I PUNËS - 2010" apo i njohur globalisht si "JOB FAIR".

Kompani dhe punëdhënës me renome nga SHBA-të do të intervistojnë studentë të USHT-së, të cilëve do t'ju jepet mundësia që gjatë sezonit veror të punojnë në kompanitë më të njohura amerikane nëpërmjet programit "WORK & TRAVEL", i cili është një program për shkëmbim kulturor të studentëve dhe mundëson qëndrim dhe aktivitet pune në SHBA, në kohën e pushimit veror me kohëzgjatje maksimale deri në 4 muaj.

Qëllimi i programit:

- *Punë dhe qëndrim (leje qëndrimi) në SHBA*
- *Njoftimi me një kulturë të re dhe mënyrë të re jetese*
- *Vizitë e një numri të madh të atraksioneve turistike në SHBA*
- *Formim të shoqërive të reja me njerëz nga e gjithë bota*
- *Jetë të pavarur në shtet tjetër, eksperiencë dhe aventurë*
- *Mundësi e jashtëzakonshme për përfitim financiar*
- *"Certificate of Completion" - Një shtesë në CV-në tuaj akademike*

Data: 04 Shkurt 2010 (e enjte).

Koha: 11:00 h.

Vendi: Amfiteatri i Rektoratit - USHT.

VËREJTJE: Të gjithë studentët të cilët duan të jenë pjesë e këtij panairi, patjetër duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin e gjejnë në zyrat rajonale të agjencisë "ZIP-Travel – Tetovë" dhe në Qendrën për Shërbime Studentore dhe Karrierë – QESHK.